



**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE  
(N.P.L.)  
QENDRA MULTIFUNKSIONALE SH.A.**

**RREGULLORE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI**

## **Mitrovicë, Dt.09.06.2020**

Bazuar në nenin 20 të Ligjit nr. 04/L-111 Për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE dhe nenin 130 të Ligjit nr. 06/L-016 Për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 04/L-012 Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe në bazë të Statutit, Bordi i Drejtorëve të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë i emëruar nga grupi i aksionareve të Komunës së Mitrovicës, si pronare në mbledhjen e mbajtur me datën 09.06.2020, e miratojnë:

### **RREGULLORE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI**

#### **I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME Neni 1.**

**1.1.** Me këtë rregullore në vështrim të Ligjit dhe me qëllim të përparimit të mbrojtjes nga zjarri, pengimi dhe eliminimin e rreziqeve dhe pasojave nga zjarri, objekte të kompanisë, përcaktohen masat e mbrojtjes nga zjarri:

- Riorganizimi i mbrojtjes nga zjarri
- Detyrat dhe obligimet në lidhje me zbatimin e masave preventive nga zjarri,
- Përgjegjësia e tyre për mos respektimin e masave të përparuara të mbrojtjes nga zjarri,
- Obligimet në rast të shpërthimit të zjarrit dhe pjesëmarrja në shuarjen e zjarrit,
- Mënyrat e kryerjes së detyrës së kontrollit të brendshëm,
- Mënyra e dhënies së lejes për kryerjen e punëve të saldimit, prerjes lëmimit në vendeve të përkohshme,
- Pajisja teknike dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit dhe mënyrat e veprimit në rast zjarri.

#### **Neni 2.**

**2.1.** Mbrojtja nga zjarri organizohet dhe pa ndërprerë zbatohet në objekte të kompanisë, në vështirim me Ligjin, Planin e mbrojtjes nga zjarri dhe dispozitat e kësaj rregullore.

#### **II. MASAT MBROJTËSE NGA ZJARRI Neni 3.**

**3.1.** Me qëllim të eliminimit të shkaqeve të zjarrit, pengimit të shpërthimit dhe zgjerimit dhe shuarjes së zjarrit, shpëtimit të njerëzve dhe pasurisë të rrezikuar me zjarr në objektet e N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, si edhe në hapësirën rreth objektit, ndërmerren këto masa mbrojtëse nga zjarri:

**3.2.** Me rastin e projektimit dhe kryerjes së punëve, në adaptimin dhe rekonstruimin e objektit ekzistues, në instalimin e stabilimenteve dhe pajisjeve në objekt, zbatohen rregullat teknike ligjore dhe normat teknike dhe standarde mbrojtjes nga zjarri.

**3.3.** Objekti duhet të ketë hidrantët, aparatet dhe pajisjen tjetër të caktuar për shuarjen e zjarrit. Numri dhe vend-lokacioni i këtyre mjeteve dhe stabilimenteve përcaktohet me Plan të mbrojtjes nga zjarri dhe me norma të parapara teknike dhe standarde për mbrojtjen nga zjarri.

**3.4.** Instalimet elektrike, të ngrohjes, rrufepritës dhe pajisjet tjera në objekt, duhet të jenë të instaluara në mënyrë që të mos paraqesin rrezik nga zjarri. Punëtorët që fushë veprimtaria e tyre dhe detyrat e punë janë të atilla që mirëmbajtja instalimet dhe stabilimentet të caktuara më pare, janë të obliguar të kryejnë kontrollin e rregullsisë dhe funksionet e rregullt të instalimeve dhe stabilimenteve, kështu që në rast të dëmtimit të tyre mos shkaktojnë zjarr.

**3.5.** Për funksionimin normal të instalimeve të cekura më parë, **përgjegjës eshtë udhëheqësi i njësisë** në të cilën kryhen punë dhe detyrat dhe punët e mirëmbajtjes të instalimeve të ndryshme dhe stabilimenteve.

**3.6.** Në hapësirat e caktuara, në të cilat mbahen ose shfrytëzohen lëngje djegëse dhe materiali eksplodues dhe përzierje eksploduese, ndalohet pirja e duhanit, përdorimi i flakës së hapur, mjeteve për ndriçim me flake-me gas dhe mjetet tjera për ndezje, përdorimi i mjeteve-veglave që lirojnë shkëndija, shfrytëzimi i pajisjeve për nxehje me hapësira që shkëlqejnë si dhe mbajtja dhe ruajtja e materialit që ka veti vet-kalllesh.

**3.7.** Me plan të mbrojtjes nga zjarri në objektet e kompanisë, caktohen lokalet në të cilat ndalohet pirja e duhanit.

**3.8.** Deponimi dhe ruajtja e materialit ndezës të lëngët dhe të gaztë, eksplodues dhe materialit tjetër, i cili eshtë lehtë-ndezës, mund të lejohet vetëm në depot e posaçme të cilat janë të ndërtuara me atë lloj dedikimi, sipas rregullave të vendosjes dhe ruajtjes së tyre.

**3.9.** Në lokalet në të cilat gjatë punës përdoren materiet e përmendura më parë, të njëjtat ruhen në enë të posaçme të parapara dhe në sasi të caktuara për punë gjatë një ndërrimi.

**3.10.** Për masa ndalimi nga pika 4, në vende të dukshme do të vendosen paralajmërimet ose shenjat e ndalimit.

**3.11.** Puna me flake të hapur dhe me stabilimente të hapura, me aparatet për saldim, mund të kryhet në lokale vetëm atëherë kur të merret leja dhe të merren masat mbrojtëse të posaçme nga zjarri dhe të sigurohen mjetet përfikjen e zjarrit.

**3.12.** Para fillimit të punëve nga pika e mëparshme, udhëheqësi do të lajmëroj **punëtorin përgjegjës për punë dhe detyra mbrojtëse nga zjarri** përvendosje kohen e kryerjes së atyre punëve, me atë rast jepet leja me shkrim përfiksuar e punëve dhe urdhërohen masa të cilat më parë duhet të ndërmarrin.

**3.13.** Materiali i shpenzuar, mjetet nga rekuizita, ambalazhe plastike, e pambuktë, ngjyra dhe materiali tjetër që tepron, duhet para se të kryhet puna te largohet nga punëtoria dhe të vendoset në vende ku e cakton punëtori përgjegjës i punëve të mbrojtjes nga zjarri.

**3.14.** Materiali nga pika e më parme, gjatë punës vendoset në enë të metali me kapakë myllës,

**3.15.** Deponimi i materialit në lokale, bëhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, duke u kujdesur që të sigurohen vend-kalimet pa pengesa/rrugët e zjarrit / dhe hapësira e duhur e materialit të deponuar nga burimi i energjisë.

**3.16.** Tymtarë, vendet e ngrohtores/kazanë/, stufat me lëndë djegëse të lëngëta dhe të ngurta, pastrohen sipas rregullave dhe standardeve nga personi që eshtë i autorizuar dhe kryen kontrollin dhe që i kryhen punë e pastrimit të tymtarëve.

**3.17.** Në çati – tavan dhe nën – kulme të objekti, është e ndaluar mbajtja e çfarëdo materiali dhe pajisje, me përjashtim të pajisjes dhe materialit përfikjen e zjarrit.

**3.18.** Në hapësirat e Ndërmarrjes Publike Lokale ". Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë si edhe në hapësirën rrëth objektit, ndalohet përdorimi i pajisjeve ngrohëse pa pëlqimin e **personit përgjegjës të MKZ**.

**3.19.** E obliguar është s'kyçja e aparateve ngrohës, aparateve elektrike dhe stabilimenteve tjera për ngrohje, pas përdorimit ë tyre.

**3.20.** Rrugët për kalim, hapësira për të u afruar, vend kalimet dhe shkallët, gjithmonë duhet të jenë të lira për kalim pa pagesa.

**3.21.** Kryerja e punëve të rrezikshme jashtë punëtorisë, e cila është e dedikuar për këto punë, mund të lejohet, vetëm me kusht që më parë të jenë siguruar masat e posaçme mbrojtëse nga zjarri.

#### **Neni 4.**

**4.1.** Stabilimentet, pajisjet e dedikuar për shuarjen e zjarrit, në N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, mund të shfrytëzohen vetëm nëse i u përgjigjen standardeve në fuqi, ose pas marrjes së atestit nga organizata profesionale, për raste që nuk janë të standardizuara.

**4.2.** Stabilimentet, pajisjet dhe mjetet për shuarjen e zjarrit, vendosen në vendet e përshtatshme në lokalet e N.P.L. . Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë dhe mund të përdoren vetëm për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, si dhe vendi ku vendosen mjetet për shuarjen e zjarrit duhet të shënohen dukshëm në vende të përshtatshme, me shenja të posaçme.

**4.3.** Stabilimentet, pajisjet dhe mjetet për shuarjen e zjarrit, mbahen në gjendjen të rregullt dhe për to mbahet evidencë e rregullit.

### **III.** **ORGANIZIMI I MBROJTJES NGA ZJARRI** **Neni 5.**

**5.1.** Për zbatimin e masave të parapara dhe të urdhëruara të mbrojtjes nga zjarri, si edhe punëve dhe detyrave të parapara me ligjin dhe me dispozita tjera nga lëmia e MZ, me këtë rregullore bëhet ky organizim:

#### **1. SEKTORI I SIGURIMIT DHE MBROJTJES KUNDËR ZJARRIT** **a) Fushë-veprimtaria e punës** **Neni 6.**

**6.1.** Punët në zbatimin e masave preventive të MZ dhe eksplodimeve në objektin e N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, i kryen sektori i sigurimit të objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

**6.2.** Numrin e punëtorëve në këtë Sektor, lloji i arsimimit shkollor të tyre si dhe kushtet tjera për themelimin e marrëdhënieς së punës, përcaktohen me akt të përgjithshme të sistematizimit në harmoni me ligjin dhe akte të tjera të organeve kompetent të mbrojtjes nga zjarri.

**6.3.** Sektori i sigurimit të objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, kryen edhe këto detyra:

- Ndërmerr të gjitha masat preventive të MZ, me qëllim të mbrojtjes së njerëzve dhe pasurisë së N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë.
- Organizon, zbaton dhe përparon mbrojtjen nga zjarri, për të ngritur shkallën e sigurisë,
- Kujdeset për zbatimin dhe përgatitjen e masave dhe dispozitave të përcaktuara me Ligj të MZ dhe ligjeve tjera, rregullave teknike, vendimeve të Kuvendit të komunës, Planit komunal të mbrojtjes nga zjarri, planit të mbrojtjes nga zjarri të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë dhe kësaj rregulloreje,
- Merr pjesë në hartimin e projekt-propozimit të akteve normative, programit dhe planeve të mbrojtjes nga zjarri,
- Pavarësisht ose në bashkëpunim me **punëtorin përgjegjës për mbrojtje e shpëtim nga zjarri dhe përsiguri dhe shëndet në punë**, kryen mësimin dhe trajnimin e të gjitha punëtorëve në lidhje me rreziqet që i kanosen nga zjarri në objekte dhe në vendin e punë, mënyrën e përdorimit dhe karakteristikat e aparateve të mbrojtjes nga zjarri,
- Kryen kontrollin e rregullsise dhe funksionalitetin e stabilimenteve për fikjen e zjarrit, mjeteve për fikjen e zjarrit dhe pajisjeve dhe pajisjes tjetër me të cilën disponon N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë dhe mban evidence të rregullt,
- Kujdeset për furnizimin, ruajtjen dhe deponimin e mjeteve dhe pajisjeve për fikjen e zjarrit,
- Jep propozime të formës optimale rreth mbrojtjes nga zjarri me rastin e aplikimit të ndërrimeve të reja teknologjike me qëllim të mbrojtjes së punëtorëve dhe pasurisë ne vendet e tyre të punës,
- Kontrollon se a janë ne vende të duhura të vendosura:
  - a) shenjat e lajmërimit, shenjat e rrezikut dhe të ndalimit
  - b) udhëzimet për përdorimin e aparateve të MZ,
  - c) të shënuara zonat e rrezikut,
  - d) a janë të ndriçuara dhe të shënuara daljet rezerve në rast zjarri,
- realizon bashkëpunimin dhe mbikëqyrjet me organizatat përkatëse për realizimin e masave të MZ, me rastin e projektimit ose adaptimit të objekteve ekzistuese, lokaleve të punës dhe lokaleve tjera,
  - kryen matjet e caktuara të nevojshme dhe shqyrtimet e grumbullimit të gazrave,
  - kryen ndërrimin dhe tërheqjen e aparateve të vjetër dhe pajisjes tjetër me rregull gjatë tërë vtitit dhe në vend të tyre sjell pajisje të re,
  - bashkëpunon për të gjitha çështjet e MZ, me komisionin e mbrojtjes në punë dhe MZ me qëllim të trajnimit të problemeve dhe zgjedhjes së tyre nga këto lëmi,
  - Drejtpërdrejt bashkëpunon me njësinë e zjarrfikësve dhe njësive tjera vullnetare të MZ,
  - Kryen kontrollin e kohëpaskohshme të objekteve të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë , me qëllim të konstatimit të lëshimeve të rregullave në zbatimin e masave preventive nga zjarri, në bazë të cilave urdhëron me shkrim evitimin e të metave të gjetura dhe jap në lidhje me këto afate të caktuara për eliminimin e tyre,
  - Me qëllim të përmirësimit dhe përparimit të MZ bashkëpunon me shërbimin profesional të Sektorit të preventives nga zjarri dhe me organizata tjera,
  - Kryen vizita kontolle ditore dhe gjatë natës me qëllim të zbatimit të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe masave preventive nga zjarri, me kusht që ndaj atyre që kthejnë rregullat, paraqet fletëparaqitjen organit kompetent të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë - Me qëllim të përparimit dhe përmirësimit të MZ, bashkëpunon me shërbimin profesional të Sektorit të preventives komunale të mbrojtjes nga zjarri;

- Kryen vizita kontrolli gjatë natës dhe ditës, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe masave preventive nga zjarri, me ç'rast për ata që thyejnë rregullat i paraqet te organi kompetent të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, për fillimin e procedurës disiplinore për lëndimin e obligimit të punës;

- Kryen kontrollin në rregullimin, pastrimin dhe mirëmbajtjes së lokaleve të Ndërmarrja Publike Lokale "Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, në veçanti në lidhje me mbylljen e hyrje-daljeve, qasjes afër hidrantëve, aparateve përfikjen e zjarrit dhe pajis doracakë përvendkalime të brendshme dhe të jashtme;

- Në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë nga zjarri dhe eksplodimeve, fatkeqësive elementare, ndërmerr masa urgjente përvitimin e menjëherës dhe efikas në eliminimin e tyre, tanë ndalon punën në vende kritike, por në atë rast menjëherë lajmëron udhëheqësin përgjegjës, i cili më tutje ndërmerr masa urgjente përvitimin e tyre;

- Me shkrim lajmëron personin përgjegjës të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, në lidhje me konstatimin e të metave dhe masave preventive, si dhe përvitimet e inspektorëve që ato t'i eliminojnë në bazë të kompetencave;

- Mbanë evidencën dhe analizon shpërthimet fillestare të zjarrit dhe kundërvajtjet e mëdha nga lëmi që e rregullon kjo rregullore;

- Me qëllim të përmirësimit dhe përvitimit të MZ, bashkëpunon me Shërbimin Profesional të MZ të Sektorit të preventives ndaj zjarrit të Kuvendit të Komunës;

- Kryen vizita kontolle ditore dhe të natës me qëllim të zbatimit të mbikëqyrjes në zbatimin e masave dhe rregullave të MZ, por, ndaj atyre që nuk i zbatojnë rregullat, ndaj tyre shkruan fletëparaqitje dhe dërgon përgjegjësitë të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, përvitit procedurën disiplinore ndaj tyre;

- Kryen kontrollin ndaj rregullsise së pastërtisë, mirëmbajtjen e lokaleve të punës dhe lokaleve tjera ndihmëse, posaçërisht në lidhje me lirimin e hyrjeve daljeve, ofrimit të aparateve dhe hidrantëve dhe mjeteve tjera ndihmëse përfikjen e zjarrit;

- Në rast të rrezikut të drejtpërdrejtë të shpërthimit të zjarrit dhe eksplodimeve, fatkeqësive elementare etj, ndërmerr masa urgjente përvitimin e shpejt dhe efikas, ndalon punën në vende kritike dhe menjëherë lajmëron eprorin e N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë;

- Me shkrim lajmëron personin përgjegjës në lidhje me të metat teknike të MZ, si dhe përvitimet e inspeksionit të mbrojtjes nga zjarri;

- Mbanë evidencën e zjarreve fillestare si edhe kundërvajtjeve të rënda nga MZ;

- Përpilon informata në lidhje me gjendjen e MZ të objektit dhe propozon masa përvitimin e tyre;

- Kryen edhe punë tjera që janë të përcaktuara me akte normative.

## **b). Punëtorët e Sektorit dhe sigurimit të objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit**

**Neni 7.**

**7.1.** Në kuadër të autorizimeve dhe fushë veprimtarisë së punës, punëtorët e Sektorit të sigurimit të objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, kanë të drejtë dhe obligime që:

- Të organizojnë, zbatojnë dhe përparojnë MZ dhe në lidhje me të, të aftësohen nga lëmia e MZ, të nënshtrohen verifikimit të dijenisë teorike dhe praktike;

- Punëtorët e Sektorit të sigurimit të objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, duhet të njohin procesin teknologjik - global dhe karakteristikat themelore të materialit që është i ndjeshëm nga

zjarri, mandej duhet të dinë organizimin e punës, përgatitjen teknike, si edhe mënyrën e veprimit në rast zjarri, ku duhet të dinë vendet më të rrezikshme nga zjarri dhe punë e detyra tjera që i urdhërohen nga eprorët;

## **2. PËRGJEGJËS PËR MBROJTJE E SHPËTIM NGA ZJARRI**

### **Neni 8.**

**8.1.** Përgjegjës për mbrojtje e shpëtim nga zjarri në Sektorin e Sigurimit të objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, në kryerjen e punëve dhe detyrave ka këto detyra:

- Zbaton masat preventive nga zjarri të përcaktuara me Ligj të MZ dhe me rregulla e dispozita të kësaj Rregullore dhe akteve tjera të përgjithshme;

- Me rregull kontrollon funksionimin e stabilimenteve dhe pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe menjëherë ndërmerr masa për evitimin e parregullsive për evitimin e pasojave të dëmshme që mund të vijnë;

- Përcakton numrin dhe vendosjen e aparateve për shuarjen e zjarrit dhe pajisjen tjetër, kontrollon rregullsinë e tyre, ndërron dhe dërgon për rregullimin e tyre;

- Merr pjesë në përgatitjen e propozimit të akteve normative nga lëmi e MZ;

- Në rast të shpërthimit të zjarrit, drejtpërdrejtë merr pjesë në përcaktimin e shkakut të zjarrit dhe në lidhje me të sjell informatë eprorit të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë;

Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë; me rregull lajmëron edhe për të gjitha dukuritë tjera negative;

- Përcjell rregullat nga lëmi e MZ dhe të arriturat nga kjo lëmi dhe propozon zbatimin e tyre në N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë;

- Propozon dhe kontrollon zbatimin e masave dhe normave tjera të MZ, me rastin e adaptimit, rekonstruimit, rregullimit dhe servisimit;

- Mbanë evidencat e duhura të parapara nga MZ, kryen edhe punë tjera;

**8.2.** Në kryerjen e punëve nga alineja e më parme, Përgjegjësi për mbrojtje e shpëtim nga zjarri, është i autorizuar:

- Të kryej kontrollin e drejtpërdrejtë në zbatimin e masave të urdhëruara nga MZ;

- Në rast të konstatimit të parregullsive dhe mangësive të cilat mund të sjellin nga zjarri;

- Urdhëron eprorit, që menjëherë ti evitoi ato parregullsi dhe të ndaloj punën e tillë;

- Përgjegjës për mbrojtje e shpëtim nga zjarri, konstaton se punëtori është nën ndikim të alkoolit, drogës apo është i paaftë për punë, informon eprorin e tyre dhe së bashku me të ndërmerr masat e largimit të tyre nga vend i punës dhe për këtë informon Drejtorin e N.P.L.Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë;

### **Neni 9.**

**9.1.** Lloji i përgatitjes shkollore dhe kushtet tjera për themelimin e marrëdhënieς së punës së Përgjegjësit për mbrojtje e shpëtim nga zjarri, përcaktohet me akt të përgjithshëm të sistematizimit të vendeve të punës në harmoni me Ligjin.

**IV.**  
**TË DREJITAT DHE OBLIGIMET E BORDIT DHE PUNËTORËVE DHE PËRGJEGJËSITË PËR**  
**MOSZBATIMIN E RREGULLAVE DHE MASAVE TË MZ**

**1. Bordi i Drejtorëve**  
**Neni 10.**

Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Qendra Muktifunksionale sh.a. në Mitrovicë, në organizimin e lëmisë së MZ, organizimin dhe përparimin e MZ, përveç punëve tjera të përcaktuara me Ligj dhe rregulla të miratuar në bazë të Ligjit dhe akteve tjera, kryen edhe këto punë dhe detyra:

- Kujdeset për sigurimin e mjeteve, përcakton mjetet e duhura për MZ dhe për mjete në disponim jep lejen e përdorimit të tyre;
- Kontrollon gjendjen e organizimit të MZ dhe nivelin e gatishmërisë e sigurisë dhe ndërmerr masa të nevojshme me qëllim të përparimit të MZ;
- Shqyrton raportet – propozimet e masave të inspeksionit të MZ, vendimet e organeve kompetente dhe ndërmerr masa që ato të meta të mënjanohen me kohë dhe në afat të paraparë;
- Përcakton përgjegjësitë materiale dhe përgjegjësitë tjera të udhëheqësve të punëtorëve me të drejta të posaçme, për mos zbatimin e masave dhe rregullave të përcaktuara për mbrojtjen e njerëzve-punëtorëve dhe pasurisë që ju kanë dhënë në kompetenca me Ligj dhe rregullave të aprovuara në bazë të Ligjit dhe me këtë Rregullore dhe me akte tjera normative;
- Formon Komisionin e Mbrotjes nga zjarri, shqyrton raportet e saja dhe bjerë vendime sipas saj;
- Kryen edhe punë tjera;

**2. Komisioni i Mbrotjes nga zjarri**  
**Neni 11.**

Me qëllim të realizimit të qëllimit dhe detyrave të mbrotjes së njerëzve dhe pasurisë nga zjarri dhe vetëmbrojtjes në tërësi, formohet Komisioni i Mbrotjes nga zjarri.

Komisionin e mbrotjes nga zjarri e formon Bordi i Drejtorëve i N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, të cilit i raporton për çdo tre muaj, gjashtë muaj dhe raport vjetor për punën e saj.

Sipas nevojës Komisioni raporton edhe për dukuri e ngjarje me raport të jashtëzakonshëm.

**Neni 12.**

Komisioni i Mbrotjes nga zjarri i ka 3 anëtarë.

Zgjedhja dhe mandate i anëtarëve të Komisionit bëhet nga Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrja Publike Lokale "Qendra Muktifunksionale sh.a. në Mitrovicë.

**Neni 13.**

Të drejtat, obligimet dhe autorizimet e Komisionit të MZ janë:

- Përcjell gjendjen e organizimit, zbatimit dhe realizimit të masave mbrojtëse nga zjarri, inicon dhe drejton masat dhe aktivitetet dhe cakton propozimet dhe përparimin e MZ;
- shqyrton raportet dhe vendimet e organeve kompetente të mbrojtjes nga zjarri, propozon masa dhe aktivitete, dhe të meta që i konstaton menjëherë i eviton;
- Shqyrton dhe propozon programin e mësimit të punëtorëve nga lëmia e MZ;
- dërgon propozimet organeve kompetente për fillimin e procedurës disiplinore të punëtorëve;

### **3. KRYESHEFI EKZEKUTIV i N.P.L. QENDRA MULTIFUNKSIONALE SH.A. në Mitrovicë**

#### **Neni 14.**

Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Qendra Muktifunksionale sh.a. në Mitrovicë, në kryerjen e punëve të MZ ka këto të drejta dhe obligime:

- Drejtpërdrejti është përgjegjës për organizimin e MZ në Ndërmarrjen Publike Lokale "Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, zbatimin e masave preventive e posaçërisht zbatimin e masave të urdhëruara;
- me rastin e vërejtjes së mospërfilljes së masave ose veprimeve, është i obliguar që menjëherë të ndërmerr masa për mënjanimin e tyre;
- I propozon Bordit të Drejtorëve, shqyrtimin e çështjeve nga lëmi e mbrojtjes nga zjarri, për të ndërmerr masa adekuate për zgjedhjen e tyre;
- Kujdesit për prurjen me kohë të MZ dhe akteve tjera nga kjo lëmi;
- Kujdeset për eliminimin të metave të vërejtura;
- Kujdeset përfurnizimin e rregullt dhe të parapara të mjeteve për shuarjen e zjarrit, shfrytëzimin racional të tyre dhe mirëmbajtjen e tyre dhe
- kujdeset përfundimin me kohë të punëtorëve mbi gjendjen, masat dhe mjetet të cilat ndërmerren në zbatimin dhe përparimin e mbrojtjes nga zjarri.

### **4. Punëtorët me të drejtat e posaçme, obligime dhe autorizime dhe udhëheqësit te tjerë të drejtpërdrejtë.**

#### **Neni 15.**

Punëtorë me të drejta të posaçme, obligime dhe autorizime si dhe udhëheqësit tjerë të drejtpërdrejt, kanë këto të drejta dhe obligime:

- Janë përgjegjës për gjendje të MZ, në kuadër të punëve të cilat i udhëheqin;
- Janë të obliguar, që në fushë veprimtarinë e punës së tyre të organizojnë dhe kontrollojnë punën e punëtorëve, në mënyrën e cila siguron sigurinë e punëtorëve dhe pasurinë;
- Kujdesen dhe ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, me qëllim të zbatimit konsekuent të masave të urdhëruara të MZ nga fushë veprimtaria e punëve që udhëheqin;
- Me rastin e organizimit të punës, kontrollojnë dhe sigurojnë zbatimin konsekuent dhe i përbahen masave të parapara dhe të urdhëruara nga MZ, e në rast të vërejtjes së të metave me kohë, ndërmarrin masa adekuate përfundimin e tyre;
- Sigurojnë bashkëpunimin me Sektorin e sigurimit të objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, me qëllim të ndërmarrjes me kohë të masave të parapara;

- Janë të obliguar që çdo punëtorë të njihet me rreziqet të cilat i kanosen nga zjarri dhe eksplodimi në vend të punës;
- Propozojnë Bordit të Drejtorëve, masa për përparimin e MZ në punë të tyre;
- Janë të detyruar nga vendi i punës, që punëtorët të cilët nuk i përbahen masave të MZ, në qoftë se në atë veprim ka elemente të lëndimit të obligimit të punës dhe të dërgojnë organet kompetente për fillimin e procedurës disiplinore;
- Të organizojnë takime pune dhe të thërrasin mbledhje për punë, me qëllim të shqyrtimit të çështjeve rreth masave të cilat duhet të ndërmerren, me qëllim të mbrojtjes efikase nga zjarri, posaçërisht me qëllim të analizimit të lëshimeve dhe të metave në zbatimin e masave preventive nga zjarri, për të dhe në propozime për shqyrtim dhe marrjen e qëndrimeve sipas rezultateve të vërejtjeve të organeve të inspektimit dhe përdorimit racional të mjeteve dhe pajisjes për fikjen e zjarrit;
- Të organizohen trajnimet e punëtorëve nga lëmia e MZ, njohja me rreziqet dhe mënyrën e përdorimit të stabilimenteve dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit;
- Kryen edhe punë tjera të cilat i kontribuojnë përparimit të MZ.

## **5. Të drejtat dhe obligimet e punëtorëve** **Neni 16.**

Punëtorët e Ndërmarrjes Publike Lokale "Qendra Muktifunksionale sh.a. në Mitrovicë, janë bartësit themelor të punëve dhe detyrave të MZ dhe kanë të drejtë dhe obligim që drejtpërdrejtë të marrin pjesë në organizimin, zbatimin dhe përparimin e punëve dhe detyrave, gjegjësisht masave mbrojtëse të posaçme dhe të përgjithshme për njerëz dhe pasuri në vështrim me ligje, këtë rregullore dhe akte tjera të përgjithshme e posaçërisht:

- Të organizojnë mbrojtjen e të gjitha vlerave të cilat disponojnë në mënyrë që të sigurojnë në tërësi sigurinë personale të njerëzve dhe të pasurisë;
- Të ndërmarrin, të zbatojnë dhe të përbahen rregullave të MZ;
- Të kërkojnë ndihmë për organet dhe organizatat të cilat këtë ndihmë duhet ta japid dhe t'i dhënë ndihmë në suaza të mundësive të tyre, posaçërisht në shuarjen e zjarrit dhe pengimin e zgjerimit të tij;
- Të dërgojnë propozime dhe kërkesa personave, organeve dhe shërbimi kompetente për ndërmarrjen e masave preventive të MZ për eliminimin e të metave ose pasojave për shëndet dhe jetë të njerëzve nga zjarri dëmeve ose shkatërrimeve të objekteve dhe pasurisë;
- Me kohë të lajmërohen me dukuritë e rrezikimit të njerëzve dhe pasurisë, me masa dhe veprime të cilat janë ndërmarrë me qëllim të eliminimit të pasojave dhe rrezikut;
- Të aftësojnë - trajnojnë dhe të kryejnë verifikimin e dijes për ndërmarrjen e drejtpërdrejtë të masave mbrojtëse, eliminimin e shkaqeve dhe rrezikimit si dhe pasojave të tyre;
- Qe gjatë punës dhe pas kryerjes së punës gjithnjë të përcillen dhe të kontrollojnë punën, funksionimin dhe rregullsinë e makinave, stabilimenteve dhe për çdo prishje dhe parregullsi menjëherë të lajmërojnë organin kompetent me qëllim të evitimit të parregullsisë, të cilat mund të rrezikojnë sigurinë e njerëzve dhe pasurinë;
- Qe me kujdes të manipulojnë me material të rrezikshëm, siç është ai ndezës, eksplodues etj., të ndërmarrin masa të duhura mbrojtëse me rastin e shfrytëzimit të tyre;
- Të kujdesen që prania e tyre në vendet e punës, të jetë i lire dhe i mundshëm në mënyrë që pa pengesa t'i qasen shfrytëzimit të mjeteve mbrojtëse dhe largimin e pasojave të tilla;

- Mjetet personale mbrojtëse dhe pajisjen në mënyrë siç është e paraparë me akt të përgjithshëm;

- Që drejtpërdrejtë të marrin pjesë në shuarjen e zjarrit nëse kanë mundësi pa rrezikuar veten dhe personat tjerë dhe atë menjëherë të lajmërojnë brigadën e zjarrfikësve dhe stacionin e polisë.

## **6. Përgjegjësit e punëtorëve për moszbatimin e masave të parapara dhe të urdhëruara.**

**Neni 17.**

Punëtorët e Ndërmarrjes Publike Lokale "Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, janë të obliguar që në punën e tyre t'i përbahen të MZ të parapara me ligj dhe aktet tjera në bazë të ligjit, plane të MZ dhe kësaj rregullore dhe masave tjera të cilat në bazë të rregullave të caktuara të cilat i urdhërojnë të autorizuarit dhe shërbimet kompetente për zbatimin e masave të MZ në Ndërmarrjen Publike Lokale "Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, si dhe organet e inspektimit të MZ;

### **Neni 18.**

Moszbatimi i masave të MZ të cekura në nenin e mëparshëm, paraqesin lëndim të rendë të obligimit të punës dhe disiplinës në vështrim të aktit të posaçëm mbi përgjegjësitetë disiplinore të ndërmarrjes.

Me qëllim të realizimit dhe detyrave të mbrojtjes së njerëzve dhe pasurisë nga zjarri dhe vetëmbrojtjes në tërësi, formohet **komisioni i mbrojtjes nga zjarri**.

**Komisionin e mbrojtjes nga zjarri** e formon Bordi i Drejtorëve i cili raporton për çdo 3 muaj, 6 muaj dhe raport vjetor për punën e tij, sipas nevojës komisioni raporton edhe për dukuri e ngjarje me raport të jashtëzakonshëm.

### **Neni 19.**

Me dispozitat e rregullores janë të obliguar që t'i zbatojnë masat e MZ të gjithë punëtorët të cilët kanë themeluar marrëdhënien e punës (në kohë të caktuar dhe të pacaktuar).

## **7. Mësimi – trajnimi i punëtorëve dhe mënyra e njohjes me masa, rreziqet dhe veprimet me rast të zjarrit**

**Neni 20.**

Mësimi i punëtorëve nga lëmia e MZ kryhet në bazë të programit i cili bëhet në bazë të dispozitave të kësaj rregullore.

Program i mësimit përmban pjesën të përgjithshme dhe të posaçme.

Me përbajtje të programit të mësimit nga alineja 2 e këtij nenit siguron arritjen e njohurisë së domosdoshme teorike dhe praktike në lidhje me masat MZ.

Program i mësimit bazohet në vërejtjet e drejtpërdrejta dhe burimet e rrezikut si dhe procesit specifik të punës të cilat duhet të respektohen.

### Neni 21.

Qëllim i mësimit – trajnimit të punëtorëve është arritja e domosdoshme të njohurisë teorike dhe praktike.

Trajnimi bëhet nëpërmjet seminareve, ligjératave, konsultimeve dhe ushtrimeve të tjera.

Shërbimi profesional përcakton format, gjegjësisht mënyrën e mbajtjes së mësimit varësisht nga parimet pedagogjike-didaktike dhe parimeve organizative realizimin e programit.

Disa pjesë ose tërësi të mësimit mund t'i besohet dhe shërbimeve përgjegjëse dhe profesionale.

### Neni 22.

Pas kryerjes së trajnimit medoemos kryhet verifikimi i dijenisë dhe aftësisë së punëtorëve.

Verifikimi, gjegjësisht aftësimi kryhet nëpërmjet testeve, por edhe verifikimin e aftësisë praktike.

Shërbimi profesional përgatitë testet, cakton dhe vendos për mënyrën e verifikimit të dijenisë.

### Neni 23.

Për verifikimin e dijenisë, përpilohet procesverbali dhe mbahet evidenca.

Punët organizative për verifikimin e dijenisë, mbajtjen e evidencës e kryen shërbimi profesional.

### Neni 24.

Punëtorët që nuk kënaqen në rezultat në verifikimin e dijenisë, janë të obliguar sërisht e më së larti në afat prej 15 ditëve nga dita e verifikimit të përsërit provimin.

Nëse edhe në verifikimin e serishëm punëtori nuk tregon rezultat, konsiderohet se nuk i plotëson kushtet për punë të mëtejmë dhe detyra.

## **V. PROCEDURA NË LIDHJE ME KRYERJEN E PUNËVE TË SALDIMIT, E PRERJES DHE LËMIMIT NË VENDET E PËRKOSSHME**

### Neni 25.

Lejen, gjegjësisht vazhdimin e lejes për kryerjen e punëve të saldimit, prerjes dhe lëmimit e jep kryepunëtori perqejges.

Personi nga alineja 1. i këtij nenit merr pjesë në pranim-dorëzimin e punëve, mban evidencën e lejeve të lëshuara, si dhe dokumentacioni tjetër në lidhje me kryerjen e këtyre punëve dhe është përgjegjës për kryerjen e punëve sipas ligjit.

## **VI. PAJISJA TEKNIKE DHE MJETET PËR SHUARJEN E ZJARRIT**

### **Neni 26.**

Me kryerjen e detyrave me sukses në mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë nga zjarri, në këtë rregullore në vështrim me vendimet e organeve kompetente në kategorizimin e enteve dhe organizatave nga rrezikshmëria e zjarrit, parashihen masa minimale teknike dhe pajisje për shuarjen e zjarrit siç janë:

- Aparatet kundër zjarrit: aparatet e dorës për shuarjen e zjarrit me pluhur dhe me CO2;
- Rrjeti i hidrantit të brendshëm për shuarjen e zjarrit.

### **Neni 27.**

Mirëmbajtjen e pajisjes dhe mjeteve për shuarjen e zjarrit, janë të obliguar të kujdesen të gjitha sektorër e objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

### **Neni 28.**

Mjetet për shuarjen e zjarrit, duhet të vendosen në vendet shënuara (të dukshëm dhe të përshtatshëm), të ashtuquajtur punkte të zjarrit në lokale dhe objekte të ndara dhe gjithmonë në gjendje të rregullt.

Aparatet për shuarjen e zjarrit duhet të kontrollohen në bazë të udhëzimit të prodhuesit së paku një herë në gjashtë muaj, gjegjësisht një herë në vit.

Servisimi dhe kontrollimi si dhe shqyrtimi i aparateve për shuarjen e zjarreve kryhet nga enti i autorizuar.

### **Neni 29.**

Llojet e pajisjes dhe mjetet për shuarjen zjarrit, vendosja e tyre më afërsisht, caktohen në plan të MZ, veç e veç për çdo objekt.

## **VII. VEPRIMET NË RAST TË SHPËRTHIMIT TË ZJARRIT DHE DETYRAT E PUNËTORËVE**

### **Neni 30.**

Çdo punëtor i N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, i cili vëren zjarrin është i obliguar ta shuan nëse atje mund ta bënë pa e rrezikuar veten ose të tjerët.

Në rast se punëtori nuk mund ta shuan zjarrin, është i obliguar që menjëherë ta lajmërojë personin përgjegjës për mbrojtje nga zjarri ose njësinë territoriale të zjarrfikësve.

### **Neni 31.**

Kur ndodh zjarri me përmasa të mëdha i cili nuk mund të shuhet me sukses me mjetet vetanake, personi përgjegjës i MZ menjëherë duhet të thërrasë njësinë territoriale të zjarrfikëseve.

### Neni 32.

Sektori i objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, posa tē njoftohet se ka shpërthyer zjarri, eshtë i obliguar menjëherë tē merr masa pér shuarjen zjarrit.

Punëtorët janë tē obliguar tē marrin pjesë në shuarjen e zjarrit dhe tē shpëtojnë njerëzit dhe pasurinë e rrezikuar.

### Neni 33.

Me tē njoftuar pér zjarrin e shkaktuar, Sektorët përgjegjës tē objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, ndërmerr këto masa:

- Punëtori kujdestar jep shenjen e alarmit pér intervenim (alarmi i jepet me sinjal ose në mënyrë tē thjeshtë);
- Punëtorët zjarrfikës tē cilët gjatë alarmit gjenden në objekt janë tē obliguar menjëherë tē paraqiten gjegjësisht tē vijnë në vendin e ngjarjes;
- Pas përcaktimit dhe llojit tē pajisjes tē nevojshme pér fikjen e zjarrit shkohet rrugës me tē shkurtë deri te vendi i ngjarjes;
- Me tē ardhur në vendin e ngjarjes, udhëheqësi i aksionit pér shuarjen e zjarrit, kryen vlerësimin e situatës, merr qëndrim pér mënyrën e shpëtimit tē njerëzve dhe pasurisë, përdorimin e llojit tē pajisjes dhe mjeteve tē cilat do tē përdoren pér shuarjen zjarrit, numrin e nevojshëm tē njerëzve, mënyrën e shuarjes së zjarrit në drejtim tē caktuar, masat sigurisë tē punëtorëve gjatë fikjes së zjarrit, përdorimin e mjeteve mbrojtëse, mënyrën e furnizimit me ujë etj.

### Neni 34.

Gjatë shfaqjes së zjarrit tē gjithë tē pranishmit ose punëtorët e ftuar, janë tē obliguar t'i kryejnë urdhrat e personit përgjegjës MZ, pér fikjen zjarrit.

### Neni 35.

Pér zjarrin e shkaktuar duhet tē lajmërohet sektori i preventives nga zjarri.

Shuarja e zjarrit, shpëtimi i njerëzve dhe pasurisë kryhet derisa tē fiket zjarri.

Njësia e zjarrfikësve nuk guxon ta lëshojet vendin e ngjarjes, gjersa udhëheqë aksionit pér shuarjen e zjarrit dhe nuk bindet se zjarri eshtë fikur.

### Neni 36.

Nëse ekziston rreziku nga shpërthimi i serishëm i zjarrit, udhëheqësi i aksionit pér shuarjen e zjarrit i cakton zjarrfikësit me numër tē duhur tē aparatave, mjetet dhe pajisjen e nevojshme.

### Neni 37.

Me të kthyer nga intervenimi, udhëheqësi i aksionit për shuarjen e zjarrit, është i obliguar të hartojë procesverbalin për ecurinë dhe rezultatet intervenimit dhe i dërgon Kryepunëtori të Sektorëve të objektit dhe mbrojtjes kundër zjarrit, i cili pastaj ja prezanton Menaxhmentit, Kryeshefit Ekzekutiv si dhe Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Qendra Multifunksionale" sh.a. në Mitrovicë.

**XIII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**  
**Neni 38.**

Për të gjitha çështjet nga lëmia MZ, që nuk janë të rregulluara në këtë rregullore do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-012 Për Mbrojtjen nga Zjarri.

**Neni 39.**

Për interpretimin e ndonjë dispozite të kësaj Rregullore është kompetent Bordi i Drejtorëve të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë.

**Neni 40.**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja e mëparshme për mbrojtjen nga zjarri.

**Neni 41.**

Kjo Rregullore aprovohet nga ana e Bordit të Drejtorëve të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë, me datën 09.06.2020 dhe ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore bëhen sipas të njëjtës procedurë, sikurse për nxjerrjen e kësaj Rregullore.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga ana e Bordit të Drejtorëve të N.P.L. Qendra Multifunksionale sh.a. në Mitrovicë.

**APROVUAR:**

**Kryesusi i Bordi**  
**Gani Rrustemi** \_\_\_\_\_

